



Prishtinë: 31.01.2022  
Kodi i ZRRE-së: V\_1483\_2022

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_2266\_11\_21** të dt. 24.11.2021;
- Ankesën e konsumatorit të dt. 19.11.2021;

në seancën e mbajtur më datë 31.01.2022 nxori këtë:

### V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar ankesa e konsumatorit V.Z, nga Komuna e Vitisë.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK\_V\_2266\_11\_21, i datës 24.11.2021.

### A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtje të Konsumatorëve në ZRrE me datë 24.11.2021 ka marrë Vendim me nr. ZRrE/DMK\_V\_2266\_11\_21, me të cilin e ka refuzuar ankesën e konsumatorit V.Z nga Komuna e Vitisë, lidhur me kontestimin e vendosjes së kufizuesit të fuqisë në njehsorin prej 15 kW.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatori V.Z, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRrE-së për këto shkaqe:

- DMK nuk ka analizuar asnjë provë, përveç asaj të dt. 04.07.2018 dhe vendimi si i tillë është i pabazuar;
- Të gjitha procesverbalet janë të paligjshme dhe të trilluara;
- Borxhi prej 14,000 EUR është krijuar në emër të kompanisë Euro – Vali N.P., e cila ka falimentuar që afro 5 vite dhe nuk është borxh i konsumatorit;
- Ndër të tjera, kërkon nga ZRrE që t'i mundësohet sa më shpejt aplikimi me shifër të re të konsumatorit dhe me njehsor 30 kW.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 31.01.2022 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pretendimin e konsumatorit se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë në ZRrE është i bazuar në prova të paligjshme, Bordi i vlerëson si jo të qëndrueshëm, për faktin se, pas analizimit të



të gjitha shkresave të lëndës, një nga një dhe të ndërlidhura njëra me tjetrën, si në vijim: kërkesa për lidhje të re e dt. 04.07.2018; Procesverbali i inspektimit i dt. 05.12.2019; Kërkesa për lidhje të re e dt. 05.12.2019; Procesverbali i inspektimit i dt. 06.01.2020; Procesverbali për pranimin e instalimit elektrik të dt. 14.10.2020; Procesverbali mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik i dt. 16.10.2020; Fatura e shërbimeve e dt. 19.10.2020; Ankesa e konsumatorit e dt. 28.10.2020; Përgjigja e KESCO-s e dt. 09.11.2020; Ankesa e konsumatorit në ZRrE e dt. 09.11.2020; Vendimin e DMK-së të dt. 24.11.2021 dhe Ankesën e konsumatorit të dt. 28.12.2021, dhe pas analizimit të secilës prej tyre, ka gjetur se, ankesa e konsumatorit V.Z është e pa bazuar, andaj edhe pretendimet se shkalla e parë në ZRrE – Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve – nuk i ka analizuar provat, ose se provat si të tilla janë të paligjshme dhe të trilluara, Bordi i vlerëson si të paqëndrueshme dhe të pa bazuara.

Pas administrimit të të gjitha shkresave të lëndës, Bordi i ZRrE-së ka konstatuar këtë gjendje faktike, se konsumatori ka bërë kërkesë zyrtare për lidhje të re si konsumator komercial, por që, pas inspektimit të pikës matëse nga punëtorët e autorizuar të KESCO-s, është vërejtur se, konsumatori ka qenë i kyçur direkt, pa njehsor. Më tej, është evidentuar se konsumatorit duhet t'i vendoset njehsori si dhe janë evidentuar pajisjet që konsumatori i ka poseduar në momentin e inspektimit. Rrjedhimisht, Bordi i ZRrE-së ka gjetur se, konsumatori nuk e ka respektuar kërkesën e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes OSSh-së, e që përmes procesverbaleve të inspektimit të pikës matëse, e kanë udhëzuar konsumatorin që të aplikoj pranë KEDS për Pëlqim të ri Elektroenergjetik, për fuqi të instaluar me të madhe se 15 kW.

Pas analizimit të Njoftimit të KESCO-s të dt. 09.11.2020 për konsumatorin V.Z, Bordi ka gjetur se, konsumatori ishte udhëzuar që të përmbushë të gjitha kushtet e nevojshme teknike, respektivisht t'i përfundoj të gjitha procedurat administrative si aplikimi për rritje të fuqisë/Pëlqim Elektroenergjetik, si dhe të përfundoj të gjitha punët e nevojshme teknike në terren deri në pranimin teknik, respektivisht, zyrtarizmin e kapacitetit energjetik.

Bordi i ZRrE-së thekson se, çdo shfrytëzim i energjisë, i cili e tejkalon fuqinë e lejuar, konsiderohet se është shfrytëzim i kontraktuar i energjisë elektrike, respektivisht, sipas nenit 32 par. 1.1 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, në mënyrë decitive përcaktohet si vijon: *“Konsumatori do të konsiderohet se shfrytëzon energji në mënyrë të pa kontraktuar nëse: 1.1. shfrytëzon energji në një mënyrë ose në sasi që nuk është si ajo që i është miratuar nga ndërmarrja e energjisë; 1.2. transmeton energji pas pikës matëse, në një vend tjetër, pa lejen e ndërmarrjes së energjisë, dhe ia përçon një shfrytëzuesi tjetër në një vend të ndryshëm nga vendi i kyçjes në rrjetë; 1.3. nuk nënshkruan kontratën me furnizuesin e energjisë brenda afatit të dhënë dhe vazhdon të shfrytëzojë energjinë pa kontratë. 2. Konsumatorët nuk duhet të ndryshojnë ose kryejnë ndonjë veprim në kyçe, pajisje matëse dhe 24/26 aparate pa pëlqimin me shkrim nga ndërmarrja e energjisë, dhe janë të obliguar që të raportojnë te furnizuesi sapo të kuptojnë për ndonjë prishje të shkaktuar në kyçe dhe në pajisjet matëse”*. Për më tepër, shfrytëzimi i paautorizuar i energjisë elektrike është vepër penale, e cila është inkriminuar në Kodin Penal të Republikës së Kosovës, në nenin 314 – Vjedhja e shërbimeve, par. 2 lidhur me par. 6 dhe në këtë kuptim, ZRrE nuk ka mandat ligjor që të trajtoj këtë natyrë të lëndëve.



Në pretendimin se procesverbalet janë të paligjshme dhe të trilluara, Bordi thekson se, këto pretendime nuk mund të merren si të mirëqena, për faktin se, zyrtarët e autorizuar të kompanisë KEDS, janë persona zyrtarë të cilët evidentojnë gjetjet e caktuara gjatë leximit të njehsorëve, varësisht prej rasteve individuale dhe kontestimi i këtyre provave, nuk ka mbështetje ligjore, sepse të njëjtat përcaktohen në legjislacionin sekondar (rregullat dhe metodologjitë e aprovuara nga ZRrE) për sektorin e energjisë.

Andaj, në harmoni me nenin 48 të Ligjit nr.05/L-031 të Procedurës së Përgjithshme Administrative, Bordi i ZRrE-së i ka vlerësuar të gjitha pretendimet e ankuesit dhe i ka analizuar të gjitha dëshmitë dhe provat që lidhen më rastin në fjalë dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 31.01.2022 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

\_\_\_\_\_  
Ymer Fejzullahu, Kryesues

\_\_\_\_\_  
Selman Hoti, anëtar

\_\_\_\_\_  
Izet Rushiti, anëtar

\_\_\_\_\_  
Lutfije Dervishi, anëtare

\_\_\_\_\_  
Gani Buçaj, anëtar



**Vendimi u dërgohet:**

- KESCO-së,
- Konsumatorit V.Z dhe
- Arkivit të ZRRE-së.